



Pranuar / Dorezuar Prijeheno/Prilato Received/Delivered	20.01.2023	2023	viti god year
Organ / Shista Organ / Jedinstvo Org. Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No.	Shtypja Printeg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBHEK	604/2023		1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1112/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi- kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1112/2022 të datës 07.12.2022 të parashtruar nga ankuesi në çështjen juridike "kontestim konkursi, duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1, Nenin 16 paragrafi 3 nën paragrafin 1.1 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/1-031 për Procedurën e Përgjithshme administrative, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.1112/2022 e datës 07.12.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. *Anulohet* Vendimi me Nr.Ref.395/2022 i datës 09.11.2022 i Komisionit të Vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë, Renditja përfundimtar e kandidatëve e datës 28.10.2022 si dhe Njoftimi me numër të protokollit 4585 i datës 28.10.2022 për shpallje të kandidatit lidhur me pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për NATO*, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- III. *Anulohet* Vendimi me Nr.Ref.396/2022 i datës 09.11.2022 i Komisionit të Vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë, Rendita përfundimtar e kandidatëve e datës 28.10.2022 si dhe Njoftimi me numër të protokollit 4584 i datës 28.10.2022 për kandidatin fitues së lëvizjes brenda kategorisë për pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Politika të Sigurisë* në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- IV. *Mbetet në fuqi* Konkursi për Lëvizje brenda kategorisë me numër referencë RN00009443, për pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për NATO*, Lista e ngushtë e kandidatëve për pozitën *Udhëheqës i Divizionit për NATO*, Konkursi për Lëvizje brenda kategorisë me numër referencë RN00009444 për pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Politika të Sigurisë*, si dhe lista përfundimtare e përzgjedhjes në listën e ngushtë për pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Politika të Sigurisë*, *ndërsa çështja kthehet* në fazën e vlerësimit të Komisionit Vlerësimi për lëvizje brenda kategorisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

V. **Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë(15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në II dhe III të dispozitivit.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ më datë 07.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7737/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.Ref.395/2022 të datës 09.11.2022 si dhe Vendimit Nr.Ref.396/2022 të datës 09.11.2022 të Komisionit Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me pretendimet ankimore së Komisioni i Vlerësimit nuk ka bërë vlerësim të drejt të ankuesit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa kjo e fundit më datë 16.12.2022 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7737/2022/ të datës 07.12.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Ref.395/2022 të datës 10.11.2022 të Komisionit Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin me numër Ref.396/2022 të datës 10.11.2022 të Komisionit Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; E-mailin e datës 04.11.2022 të drejtuar _____ E-mailin e datës 28.10.2022 të Burimeve Njerëzore në MPJ drejtuar Ministrisë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;Renditja përfundimtare e kandidatëve për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Nato; E-mailin e datës 14.11.2022 të Menaxhimi e Burimeve Njerëzore-MPJD drejtuar _____ Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 8008/2022 e datës 13.12.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 8181/2022 të datës 16.12.2022; Konkursin për kandidatët _____ dhe _____ lëvizja brenda kategorisë të datës 20.07.2022 për pozitën e punës “Udhëheqës i Divizionit për Nato”; Listën SIMBNJ me numër të referencës RN00009443 të aplikantëve _____ dhe _____ të Aprovuar për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Nato”; Vendimin me numër Ref.310/2022 të e datës 17.10.2022 për kandidatin _____ i cili i ka plotësuar kriteret për lëvizje brenda kategorisë sipas konkursit të publikuar; Vendimin me numër Ref.311/2022 e datës 17.10.2022 për kandidatin _____ i cili i ka plotësuar kriteret për lëvizje brenda kategorisë sipas konkursit të publikuar; Njoftimin me numër të protokollit 4347 e datës 18.10.2022 për listën e kandidateve _____ dhe _____ të përzgjedhur për testin me shkrim; Vendimin me numër Ref.375/2022 të datës 26.10.2022 për themelimin e Komisionit të Vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë (KVLBK); Listën (pa numër dhe datë) të kandidateve të përzgjedhur për testim me gojë -Intervistë; Procesverbalin numër Ref: N00009443 të datës 28.10.2022 për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për NATO; Listën përfundimtare të kandidateve me numër të referencës L. Vrapça dhe A.Panxha e datës 28.10.2022; Njoftimin numër

protokolli 4585 e datës 28.10.2022 të Menaxherit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme për kandidatin fitues Dosjen e ankuesit; Aplikacioni i kandidatit e datës 15.08.2022; Diplomën Universitare të kandidatit me NR. 952 e datës 31.01.2011 me të cilin mori titullin Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze; Diplomën Universitare të kandidatit me numër 06/15 e datës 20.03.2015 me të cilin mori titullin Master në Menaxhment; Dokumentin e identifikimit; Aktin e emërimit me numër protokoli:1094/2018 e datës 30.11.2018; Vërtetimin me numër protokoli 184/2022 e datës 28.07.2022 të lëshuar nga Zyrtarja e Lartë e Personelit në Zyrën e Kryeministrit; Konfirmimin me numër protokoli: 185/2022 e datës 28.07.2022 e lëshuar nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit; Kontratën me Nr.622/2 e datës 08.10.2009 për marrëdhënien e punës në Institutin për Studime Ekonomike dhe Sociale "Universum"; Vërtetimin e datës 24.02.2020 të lëshuar nga menaxhues në shkollën Britanika; Vërtetimin me numër protokoli 483/09 të datës 18.06.2009 të lëshuar nga Drejtor në Kolegjin "Mehmet Akif"; Certifikatën me numër Regj.959/22 të datës 28.07.2022 të lëshuar nga Drejtori në Qendrën për Punë Sociale-Pejë; Certifikatën nën shenjën PN.NR./KR.BR 3249/22 e datës 03.06.2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë me të cilën dëshmohet se ndaj kandidatit nuk është duke u zhvilluar procedure penale; Vërtetimin me numër Ref: 04/857 e datës 30.06.2009 e lëshuar nga Sekretari i Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Prishtinës; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin "Lidershipi dhe Aftësitë Menaxhuese" për periudhën kohore 26 dhe 27 tetor 2021; Dosjen e kandidatit Aplikacionin me numër të referencës RN00009443 të datës 17.08.2022 të kandidatit Dokumentin e identifikimit; Diplomën Universitare me Nr.3468 të datës 02.09.2015 me të cilin mori titullin Bachelor i Jurist i Diplomuar; Vërtetimin e kopjes nga origjinali LRP nr.10220/2021 e datës 01.12.2021 të lëshuar nga noteri Diplomën Universitare me numër 1034 e datës 09.11.2009 me të cilin kandidati mori titullin Bachelor i Shkencave Politike; Vërtetimin e kopjes nga origjinali LRP nr.10222/2021 e datës 01.12.2021 të lëshuar nga Noteri Diplomën Universitare me Nr.130 të datës 29.09.2011 me të cilin mori titullin Master Shkencor në Shkenca Politike-Teori Politike; Vërtetimin e kopjes nga origjinali LRP nr.10221/2021 të datës 01.12.2021 të lëshuar nga Noteri Vendimin me Nr.61254 të datës 28.04.2015 të lëshuar nga Kryetarja e Këshillit Kombëtar për Njohje në Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë; Vërtetimin e kopjes nga origjinali LRP nr.10223/2021 e datës 01.12.2021 të lëshuar nga Noteri Aktin e emërimit me numër AE.nr.01-112-962 të datës 06.12.2021 të kandidatit Vërtetimin me 01 nr.962 të datës 02.12.2021 të lëshuar nga Menaxherii Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës lidhur me përvojën e punës së kandidatit Vërtetimin me nr.034 të datës 17.08.2022 të lëshuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore lidhur me përvojën e punës së kandidatit në Komunën e Prishtinës; Certifikatën e datës 16.08.2022 nën shenjën PN.NR.KR.Br.20473/22 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me të cilën dëshmohet se ndaj kandidatit nuk është duke u zhvilluar procedure penale; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 të datës 07.12.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 të datës 29.01.2021; Certifikatën lidhur me përfundimin e Kursit "Globart Academy" Learning Democracy-a në challenge për periudhën kohore 27-29 Prill-2009 të lëshuar nga në Universitetin e Prishtinës; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Promoting Gender Equality Through Education and Training" për periudhën kohore 22 korrik-02 gusht-2013 të lëshuar nga në Universitetin e Prishtinës; Certifikatën të datës 21.09.2014 lidhur me përfundimin e trajnimit "ProProtocol-Issues This"; Certifikatën pa numër të vitit Nëntor-2013 me të cilën dëshmohet se kandidati ka përfunduar trajnimin e moduleve I.II.III.IV.V "Political Academy- For Progressive Youth; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në "Course in English Language " për

periudhën kohore 27.07.2015 dhe 18.12.2015; Certifikatën pa datë lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin "Administrative Procedurës"; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen "Transformation Leadership Program Public Service Courses", të muajit Qershor 2017 të lëshuar nga ne USAID dhe në RIT Kosova; Certifikatën të datës 27.11.2016 të lëshuar nga në KCSS; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Shkolla për Integritet Evropian" për periudhën kohore 21 Shtator deri me 16 Dhjetor 2012; Certifikatën e datës 16.12.2014 lidhur me përfundimin e trajnimit "Forcimi i riparimit dhe ri integrimin e qëndrueshëm në Kosovës" të lëshuar nga Drejtoresha e MIA; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në "Public Diplomacy in the Balkans Internal and External Effects" për periudhën kohore 08.07.2020 deri 20.07.2012; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Advocacy and Reporting" për periudhën kohore 01-02 nëntor 2012; Certifikatën me numër 32 të datës 29.05.2004 lëshuar nga Qendrën për Aftësimin Profesional "Dituria" lidhur me përfundimin e kursit të Gjuhës Gjermane; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin 3 ditor "Bashkëpunim Ndërsektorial në muajin Mars-2018"; Ankesën e datës 04.11.2022 të parashtruar nga ankuesi në MPJD për pozitat "Udhëheqëse i Divizionit për bashkëpunim me NATO" si dhe "Udhëheqës i Divizionit për Siguri"; Vendimin me Nr.REF.395/2022 të datës 10.11.2022 të Komisionit Vlerësues për Lëvizje Paralele në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Konkursin me numër reference RN00009444 të datës 20.07.2022 për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Politika të Sigurisë"; Listën SIMBNJ me Numër reference RN00009444; Vendimin me NR.REF.315/2022 të datës 18.10.2022 të Komisionit Vlerësues për Lëvizje Paralele në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin me Nr. ref.314/2022 të datës 17.10.2022 të Zyrtares së Lartë të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin me Nref.372/2022 të datës 26.10.2022 për Themelimin e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë; Procesverbalin me numër reference:RN00009444 të datës 28.10.2022 për pozitën "Udhëheqjen i Divizionit për Politika të Sigurisë"; Renditja përfundimtare e kandidatëve për pozitën -Udhëheqës i Divizionit për Politika të Sigurisë; Njoftimin me numër protokoll 4584 të datës 28.10.2022 për kandidatin fitues për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Politika të Sigurisë"; Aplikacionin e datës 15.08.2022 të kandidati Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional të datës 28.01.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019; Aplikacionin e kandidati e datës 17.08.2022; Vendimin me Nr.ref.396/2022 te datës 09.11.2022 të Kryesueses së Komisionit te Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datë 20.07.2022 ka publikuar në sistem qendror elektronik (SIMBNJ) Konkursin me numër reference RN00009443 për lëvizje brenda kategorisë, për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për NATO" si dhe Konkursin me numër reference RN00009444 për lëvizje brenda kategorisë, për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Politika të Sigurisë", e në të cilat konkurse ka aplikuar edhe ankuesi. Të dy konkurset kanë qenë të hapura për aplikim nga data 05.08.2022 deri me 19.08.2022, ndërsa bazuar në listën e aplikantëve në konkursin për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për NATO", rezultoi se numri i kandidateve aplikues ka qenë katër, ku vetëm dy prej tyre (përfshirë ankuesin) janë përfshirë në listën e ngushtë përkatësisht janë vlerësuar që kanë plotësuar kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme formale të përcaktuara me konkurs. Po ashtu, sipas listës së aplikantëve në konkursin për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Politika të Sigurisë", numri i kandidateve aplikant ka qenë

pesë ku dy prej tyre (përfshirë ankuesin) janë përfshirë në listën e ngushtë përkatësisht janë vlerësuar që kanë plotësuar kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme formale të përcaktuara me konkurs.

Bazuar në listën përfundimtare të përzgjedhjes të Komisionit të Vlerësimit i themeluar me Vendimin Nr.Ref.375/2022 të datës 26.10.2022, në konkursin për pozitë *Udhëheqës i Divizionit për NATO*, rrjedhë së ankuesi është vlerësuar me gjithsej 45.4 pikë, duke u renditur si kandidat i dytë, ndërsa dhe për pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Politika të Sigurisë*, ankuesi është vlerësuar me gjithsej 46 pikë, duke u renditur po ashtu si kandidati i dytë.

Ankuesi i pakënaqur me vlerësimin e Komisionit të Vlerësimit, brenda afatit ligjor parashtron ankesë të brendshme të Komisioni i Vlerësimit duke atakuar të ky konkurset, ndërsa Komisioni i Vlerësimit me Vendimin Nr.Ref.395/2022 të datës 09.11.2022 si dhe me Vendimin me Nr.Ref.396/2022 të datës 09.11.2022 ka refuzuar ankesat e ankuesit si të pabazuara.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së Komisioni i Vlerësimit nuk ka bërë vlerësim të drejtë të ankuesit, duke shtuar së i njëjti ka dhënë përgjigje të sakta dhe së Komisioni nuk ka procesverbal lidhur me evidentimin e përgjigjeve.

Sipas Konkursit më numër reference RN00009443 për pozitën punës *“Udhëheqës i Divizionit për NATO”* si kërkesat e përgjithshme formale janë vendosur: *Arsinimi i kërkuar: Diplomë universitare, në shkenca të Sigurisë, Juridike ose shkenca tjera shoqërore, me të paktën 240 kredi apo ekuivalente me to;* kurse sipas Konkursit me numër reference RN00009444 për pozitën e punës *“Udhëheqës i Divizionit për politika të Sigurisë”* si kërkesat e përgjithshme formale janë vendosur: *Arsinimi i kërkuar: Diplomë universitare,, në Shkenca të Sigurisë, Shkenca Politike, Juridike ose shkenca tjera shoqërore, me të paktën 240 kredi apo ekuivalente me to.*

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë të cilat rregullojnë procedurën e lëvizjes brenda kategorisë, gjegjësisht nenit 38 të këtij ligji me të cilin është përcaktuar se: *“1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni”. ...5. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision vlerësimi, i krijuar në çdo institucion, bazuar në një intervistë me kandidatët. Komision përbëhet nga pesë anëtarë, njëri nga të cilët është domosdo përfaqësues i Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t'u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm .*

Po ashtu, Kolegji ka analizuar edhe dispozita e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht: Nenin 44 më të cilin është përcaktuar se: *“1.Konkurimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ, ndërsa vlerësimi i kandidateve kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, krijuar sipas nenit 47 të kësaj Rregulloreje 3.Dispozitat, për procedurën e pranimin në shërbimin civil, të kësaj*

Rregulloreje, do të zbatohen përshtatshëmrisht edhe për procedurën e konkurimit për lëvizjen brenda kategorisë, për aq sa nuk përcaktohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të kësaj rregullore”, nenin 47 me të cilin përcaktohet se: “1.KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4.Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pikë”, nenin 48 me të cilin përcaktohet se: “...Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbliidhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbliidhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësinin përfundimtar të konkurrimit”, si dhe nenin 49 me të cilin përcaktohet se: “1.KVLB në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda njëzetë e katër (24) orëve nga miratimi i saj. 2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurrimi. 3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues”.

Duke u bazuar në dispozitat si me lartë, e në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar provat materiale të çështjes dhe si rrjedhojë ka konstatuar së lidhur me procedurën e vlerësimit të kandidateve për të dy konkurset e kontestuar, ekziston vetëm shkresa me emërtimin “Renditja përfundimtare e kandidatëve”, e cila përmban vetëm një listë me pikët e përgjithshme të kandidateve, duke mos evidentuar asnjë detaj lidhur me rrjedhën e kësaj procedure dhe në veçanti lidhur me mënyrën e vlerësimit të kandidateve nga anëtarët e Komisionit. Andaj, mbi bazën e këtyre fakteve, Kolegji i Këshillit vlerëson së Komisioni i Vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka vepruar në kundërshtim me ligjin material gjegjësisht nenin 44 paragrafi 3 lidhur me nenin 25 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit ka konstatuar së Komisioni i Vlerësimit në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, nuk ka hartuar dhe miratuar aktin e përfundimit të procedurës të konkurrimit edhe një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 25 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikë së Kosovës.

Për sa me sipër, Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 97 paragrafi 2 të këtij ligji më të cilin është përcaktuar se: “... 2.Përfundimi i një procedure administrative të nisur sipas detyrës zyrtare është në diskrecionin e organit publik, përpos kur parashihet ndryshe me ligj dhe bëhet me akt administrativ, dhe si rrjedhojë konstatoi se Komisioni i Vlerësimit me rastin e përfundimit të procedurës së lëvizjes brenda kategorisë, për të dy pozitat duhet të nxjerr akt përfundimtar i cili duhet të përmbaj të gjitha elementet e aktit administrativ të përcaktuara me nenin 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, meqenëse është konstatuar se procedura e vlerësimit të kandidateve lidhur me Konkursin me nume reference RN00009443 për pozitën e punës “Udhëheqës i Divizionit për NATO” si dhe Konkursin me nume reference RN00009444 për pozitën e punës “Udhëheqës i

Divizionit për Politika të Sigurisë" në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës janë përcjell me shkelje ligjore, Kolegji i Këshillit vlerëson së pretendimet ankimore të ankuesit janë të drejta dhe të bazuar, ndërsa duke qenë së akti i shpalljes së konkursit me numër reference RN00009443 për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për NATO" si dhe akti i shpalljes së konkursit me numër reference RN00009444 për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Politika të Sigurisë" si dhe lista e ngushtë për të dy pozitat në fjalë nuk janë të përfshira me të meta procedurale dhe materiale, Kolegji i Këshillit vendosi që të anulohen të gjitha veprimet administrative të përcaktuar si në dispozitiv të këtij vendimi, me detyrimin që Komisioni i Vlerësimit në procedurë të vlerësimit të kandidatëve të merr parasysht të gjeturat dhe pikëpamjet juridike të Kolegjit të dhëna sipas këtij vendimi.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1112/2022;

Ilirë Mehmeti Shaqiri

Proçesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Dëmi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.